



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 666/2 Prot.

Tiranë, më 31/5/2013

Lënda: Urdhër për Kontrolluesin "MAI" SH.A., Tiranë.

U R D H Ë R
Nr 14, datë 31/05/2013

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të Kontrolluesit, "MAI" SH.A., Tiranë.

KONSTATOVA

Më datë 15/05/2013, nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit ka përfunduar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit, "IDRA Research & Consulting", Tiranë me cilësinë e kontrolluesit që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

I. Objekti i kontrollit:

- Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale prej kontrolluesit "IDRA Research & Consulting" Sh.p.k., Tiranë, për kategorinë e subjekteve të të dhënave "Anketues":

Në zbatim të Urdhërit Nr.10, datë 08.01.2013, pranë kontrolluesit "MAI" SH.A, Tiranë, u krye hetimi administrativ nga grupi i përbërë prej Inspektorit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit, zj. , dhe specialistit IT, z.

Inspektimi pranë këtij kontrolluesi u krye, sipas objektit të përcaktuar në Urdhrin nr.10, datë 08.01.2013 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me përmbajtjen si më poshtë:

1-Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale, sipas nenit 8 dhe 9 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, në lidhje me:

- Transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale.

Kontrolli administrativ pranë kontrolluesit, "MAI" SH.A, Tiranë, u krye në bazë të informacionit të Drejtorisë së Regjistrimit, në lidhje me shkresën nr.93/3prot., datë 20.04.2010, dërguar këtij kontrolluesi, si më poshtë vijon:

Në zbatim të nenit 21 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", Ju keni plotësuar dhe dërguar më datë 14.04.2010 Formularin e Njoftimit në Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Pas shqyrtimit të këtij deklarimi, nëpërmjet Formularit, konstatuam se informacioni i deklaruar prej jush në disa prej rubrikave ka nevojë të saktësohet, si më poshtë vijon:

Ju lutemi bëni përshkrimin e programit (software) në Rubrikën 3.2.

Në rubrikën 7, të Formularit të Njoftimit, deklaroni se përpunoni të dhëna sensitive për "shëndetin", për kategorinë "Klientë", siç dhe keni specifikuar në Rubrikën 5. Nisur nga kjo ju lutemi të sqaroni për sa më poshtë :

1. Në cilin legjislacion bazohet përpunimi i këtyre të dhënave sensitive,
2. Në cilën formë informohet subjekti i të dhënave për përpunimin e të dhënave të tij sensitive,
3. Për sa kohë mbahen këto të dhëna.

Krahas arsyes që keni dhënë te Rubrika 9 se pse i transferoni të dhënat personale, ju lutemi riplotësojeni duke specifikuar dhe shtetet brenda dhe jashtë BE-së ku i transferoni, si dhe subjektet në këto vende të cilëve u transferoni këto të dhëna.

Gjithashtu ju lutemi deklaroni në nënrubrikën 10.1, duke u përgjigjur pyetjeve të vëna në dispozicion.

Për sa më sipër, pa patur nevojën të riplotësoni edhe njëherë Formularin, bazuar në nenet 23 dhe 32/1 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale",

-Ajo që është pa pasojë në këtë mosreagim të këtij kontrolluesi, është fakti që, ky kontrollues nuk realizonte transferim të të dhënave personale, si dhe,

-Nuk përpunonte të dhëna personale të subjekteve fizikë të identifikueshëm.

-Por është e nevojshme të qartësojmë se, ky kontrollues, e ushtronte aktivitetin e tij me dy punonjës, nga të cilët asnjëri nuk ka qënë i punësuar në ky kontrollues për periudhën kur kjo korespondencë nuk ka qënë e frytshme, si dhe duhet të theksoj se, Komisioneri nuk ka qëllim parësor vjeljen e gjobave, por sensibilizimin dhe mbikëqyrjen në përputhje me ligjin.

Grupi i kontrollit, pasi u njoh me provat e paraqitura, sipas kërkesave të grupit dhe informacionit që ju vu në dispozicion të këtij kontrolli, hartoi proces verbalin e mbajtur me këtë rast, i cili daton më 20.05.2013.

-Për sa i përket pikave të konstatuara me të drejtë nga Drejtorja e Regjistrimit, konstatime këto të nxjerra nga të dhënat e Formularit të Njoftimit të depozituar nga kontrolluesi "MAI" SH.A., Tiranë konstatoj se, kontrolluesi duke qënë para faktit, të përmbushjes së një detyrimi të lënë në afat, e ka plotësuar këtë detyrim dhe afat, apriori, pa patur dijeni rreth ligjit nr.9887, datë 10.03.2013, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

Nisur sa më sipër, e në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar si dhe neneve 107-109 të K.Pr.Administrative ;

U R D H Ë R O J

1-Kontrolluesi, **“MAI” SH.A.,Tiranë**, të njoftojë pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sapo ky kontrollues të fillojë mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale të subjekteve fizikë;

2) Kontrolluesi, **“MAI” SH.A.,Tiranë**, të njoftojë pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sapo ky kontrollues të synojë, kryerjen e transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

